

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “STUDIO LIGJORE BALLUKU & ÇELA” SHPK

Mbështetur në Kushtetutën Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, me vullnetin tonë të lirë, të shprehur me nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortakët:

1. Hektor Balluku, i biri i Ilirit, lindur në Tiranë më 03.10.1983, me nr.personal I31003043L, me numër liçence avokati 5892, banues në rrugën “Ali Demi”, P.70, Shk.6, Ap.55, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Ardi Çela, i biri i Ismailit, lindur në Berlin më 01.09.1987, me nr.personal I70901055H, me numër liçence avokati 11004, banues në rrugën “Ali Demi”, Nd.25, H.3, Ap.11, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;


Sot më datë 16.05.2022 krijojmë shoqërinë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “Studio Ligjore Balluku & Çela” SHPK, me këtë akt-themelimi si vijon:

NENI 1 Legjislacioni


Shoqëria tregtare private e quajtur “Studio Ligjore Balluku & Çela” SHPK do ti nënshtrohet ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr.55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe çdo ligji apo akti nënligjor Shqiptar në fuqi, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Gjithashtu, Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues të cilat do të jenë dy akte bazë të kësaj shoqërie.

NENI 2 Selia

Qendra e kësaj Shoqërie do të jetë në Tiranë, Rruga “Ali Demi”, Nd.25, H.3, Ap.11. Me vendim të asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet qendra e saj, si dhe mund të hapen degë dhe filiale të tjera në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.



1



NENI 3 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë i kësaj shoqërie do të jetë:

- Këshillime ligjore për persona fizikë dhe juridikë;
- Përfaqësim në procese penale, civile dhe administrative, ose ndonjë natyrë tjetër që nuk përfshihet në këto kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizimi tjetër pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësim në proceset e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit;
- Përfaqësim i personave fizikë dhe juridikë sipas parashikimeve në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Hartim i akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë i kësaj shoqërie mund të ndryshohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

NENI 4 Kapitali

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10.000 Lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues **Hektor BALLUKU**: Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme **5,000 lekë**, që përben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2.Ortaku themelues **Ardi ÇELA**: Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme **5,000 lekë**, që përben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

NENI 5 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të kësaj shoqërie do të jetë me afat të pacaktuar, por shoqëria mund të ndryshojë këtë afat me vendim të asamblesë së përgjithshme. Kjo shoqëri mund të shpërbëhet sipas rasteve të parashikuara në statutin e kësaj shoqërie.

NENI 6 Fillimi i aktivitetit

Aktiviteti tregtar i shoqërisë si dhe fitimi i personalitetit juridik fillon me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar të Q.K.B.



NENI 7
Shpërndarja e fitimit

Të ardhurat neto të shoqërisë (fitimi) do të ndahen midis ortakëve sipas kuotave që zotërojnë.

NENI 9
Organizimi

Organizimi dhe administrimi i brendshëm i shoqërisë bëhet në përputhje me Statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Sipas vendimit të ortakëve në këtë akt themelimi, administratori i shoqërisë do të jetë:

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

-Ardi Ismail Çela
Nr.personal I70901055H
Adresa: Rruga "Ali Demi",
Nd.25, H.3, Ap.11, Tiranë



Administratori i mësipërm emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemërimi


NENI 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi pasi lexohet nen për nen dhe ortakët themelues janë dakord me to, e miratojnë dhe e nënshkruajnë secili

ORTAKET
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"STUDIO LIGJORE BALLUKU & ÇELA" SHPK

Hektor BALLUKU



Ardi ÇELA

